



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës  
Seksioni i monitorimit të sistemit ligjor**

**Kosovë**

---

**Administrimi i drejtësisë – Raporti i nëntë**

---

---

**PËRMBAJTJA**

<b>ADMINISTRIMI I DREJTËSISË – RAPORTI I NËNTË.....</b>	<b>1</b>
<i>SHKURTESAT .....</i>	<i>3</i>
<i>Hyrje.....</i>	<i>4</i>
<i>Fushëveprimi.....</i>	<i>4</i>
<i>E kaluara dhe zhvillimi i sistemit të drejtësisë dhe mungesa e anëtarëve nga rradhët e minoriteteve .....</i>	<i>4</i>
<i>Mungesa e personelit në gjykata .....</i>	<i>8</i>
<i>Dërgimi i dokumenteve gjyqësore.....</i>	<i>14</i>
<i>Menagjimi i fluksit të lëndëve.....</i>	<i>17</i>
<i>Problemet tjera logjistike.....</i>	<i>19</i>
<i>Rekomandimet.....</i>	<i>21</i>

## **SHKURTESAT**

DAD	Departamenti Administrativ i Drejtësisë
DPJ	Departamenti për Punë Juridike
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
SEGJ	Sistemi Emergjent Gjyqësor
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP RFJ	Ligji Penal i RFJ-së
LPP RFJ	Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së
MNDCP	Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
GJNPR	Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ruandën
KPK	Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës mbi Çështjet Juridike
SHIGJ	Shërbimi i Inspektionit Gjyqësor
KFOR	Forcat e Kosovës
GJKKLE	Gjykata e Kosovës për Krime Lufte dhe Etnike
SMSL	Seksioni për Monitorim të Sistemit Ligjor
NATO	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RKS	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KTK	Komiteti Teknik Këshilldhënës i Judikaturës dhe Prokurorisë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Hyrje

Sekcioni i monitorimit të sistemit ligjor (SMSL), si pjesë e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimit të së drejtës në kuadër të OSBE-së, është i autorizuar të bëjë monitorimin e sistemit ligjor nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe të bëjë rekomandime për qëllim të krijimit të një sistemi ligjor, i mbështetur në respektimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ky raport, do të analizoj dimenzionin administrativ të sistemit penal gjyqësor në Kosovë, dhe do të identifikoj pengesat më të theksuara të natyrës teknike dhe administrative në administrimin e duhur të drejtësisë.

## Fushëveprimi

Sistemi i mirë funksional gjyqësor, i bazuar në parimet themelore për të drejtat e njeriut përkitazi me procesin e rregullt dhe të drejtë gjyqësor, përbëhet jo vetëm nga korniza ligjore themelore, policia, prokuroria publike dhe judikatura, por nga një strukturë e tërë e përkrahjes, e cila i'u mundëson këtyre organeve të funksionojnë si duhet. Kjo strukturë përfshinë: personelin administrativ, siç janë, procesmbajtësit, nëpunësit, interpretët; ndihmën teknike, siç janë, telefonat, kompjuterët, makinat e shkrimit, aparatet e fotokopjimit dhe të fax-it, ngrohjen; dhe në fund, disponibilitetin dhe qasshmërinë ndaj materialit ligjor, siç është, legjislacioni, jurisprudenca dhe komentaret.

## **E kaluara dhe zhvillimi i sistemit të drejtësisë dhe mungesa e anëtarëve nga rradhët e minoriteteve**

Kur Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara Misioni në Kosovë (UNMIK) arrijti në Kosovë, në qershor të v. 1999 në periudhën pas konfliktit të armatosur dhe fushatës së bombardimeve të NATO-s, nuk ekzistonte sistemi i vendosur dhe funksionues i drejtësisë.

Më 28 qershor të v.1999, nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), ishte themeluar *Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës Mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore* (KPK) për të rekomanduar emërimin e përkohshëm të gjykatësve dhe prokurorëve për një sistem emergjent të drejtësisë(SGJE).

Me vendimin e PSSP, KPK u shpërbë më 7 shtator të v.1999 dhe u zëvendësua nga Komisioni Këshillues Gjyqësor (KKGJ), i cili filloi aktivitetin e tij më 27 tetor të v.1999. Më 11 dhe 12 dhjetor 1999, pas pranimit të më tepër se 700 aplikacioneve dhe mbajtjes së përafërsisht 560 intervistave, KKGJ i dërgoi PSSP-së rekomandimet për më tepër se 300 gjykatës dhe prokurorë dhe për më shumë se 200 gjykatës porot. Ceremonitë e para të dhënjes së betimeve të gjykatësve në sistemin e rregullt të drejtësisë, ishin mbajtur në janar të v.2000. Që nga qeshori i v.2000, sistemi i rregullt gjyqësor ishte funksional për sa i përket rasteve penale, në tërë Kosovën.

Përkundër rithemelimit të sukseshëm të sistemit gjyqësor për më pak se një vit dhe në frymë të përpjekjeve të mëdha për të zhvilluar më tej sistemin gjyqësor, një numër problemesh në relacion me administrimin e gjyqësisë kanë mbetur të pa zgjidhura.

Një ndër problemet më fundamentale të vërejtura brenda sistemit gjyqësor është mungesa e vazhdueshme e pjesëmarrjes së komuniteteve minoritare. Niveli i ulët i pjesëmarrjes së anëtarëve të komuniteteve minoritare - posaçërisht serbëve të Kosovës – në sistemin gjyqësor, në kombinim me klimën e gjatë dhe të vazhdueshme të konfliktit etnik, kanë ndriçuar shqetësimin në anshmërinë aktuale, apo të vërejtur, në mesin e komunitetit serb. Kjo ka qenë e shqetësimit të veçantë në rastet që involvonin anëtarët e komuniteteve minoritare të implikuar në krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur, në mes të vjeshtës 1998 dhe pranverës 1999. Këto raste kryesisht ishin hetuar nga gjykatësit shqiptarë të Kosovës, e më pastaj dëgjuar nga kolegjet me shumicë shqiptarë të Kosovës.

Pas themelimit të SEGJ gjatë verës 1999, dhe duke përcjellur rekomandimet e KPGJ, PSSP, kishte emëruar gjithësejt 55 gjykatës dhe prokurorë, nga të cilët 42 shqiptarë të Kosovës, shtatë (7) serb të Kosovës, katër (4) musliman sllav, një (1) turk dhe një (1) rom. Sidoqoftë, që nga fillimi i tetorit 1999, të gjithë anëtarët e minoritetit serb të Kosovës, kanë dhënë dorëheqje nga emërimet e tyre. Me themelimin e sistemit të rregullt gjyqësor, tetë gjykatës minoritar, përfshirë dy (2) serb të Kosovës, kishin dhënë betimin. Në të njëjtën kohë, nga vetëm dy (2) prokurorë publik, që i takonin komuniteteve minoritare, asnjëri nuk ishte serb i Kosovës. Për shkak të shqetësimeve të sigurisë dhe presionit nga Beogradi<sup>1</sup> që nga shtatori i v.2000, megjithatë, serbët e Kosovës refuzuan të punojnë.

Me 7 dhjetor të v.2000, përbërja etnike brenda gjyqësisë ishte si në vijim:

	Gjithsejt	Shqiptarë të Kosovës	Serb të Kosovës	Musliman Sllav	RAE <sup>2</sup>	Turq të Kosovës
Gjykatës	315	294 (93,34%)	2 (0,63%)	11 (3,5%)	3 (0,95%)	5 (1,58%)
Prokurorë	48	45 (93,4 %)	0 (0%)	1 (2,2%)	1 (2,2%)	1 (2,2%)
Gjykatës Porotë	414	368 (88,98 %)	11 (2,65%)	21 (5%)	4 (0,96%)	10 (2,41%)

Tani janë, 340 gjykatës dhe prokuror dhe 456 gjykatës porotë të emëruar në 55 gjykata të Kosovës. Nga këta 340 gjykatës dhe prokurorë, 16 prej tyre janë serb të Kosovës (vetëm 4 prej tyre punojnë), shtatë (7) turq të Kosovës, 12 musliman të Kosovës (vetëm 10 punojnë) dhe dy (2) romë të Kosovës. Sipas dispozitave në buxhetin e konsoliduar të

<sup>1</sup> Shiko më tej Raportin e OSBE-së mbi Aktivitetet Paralele Gjyqësore në Kosovën Veriore

<sup>2</sup> Rom/Egjiptian/Ashkali.

Kosovës (BKK), gjyqësia dhe shërbimi i prokurorisë, duhet të përfshijë 420 gjykatës dhe prokurorë; pra, është ekziston mungesë e vijueshme edhe për 80 gjykatës dhe prokurorë.<sup>3</sup>

#### *Inkuadrimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar*

Inkuadrimi i parë i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në gjyqësi, aktualisht ishte si përgjigje ndaj shqetësimit publik, dhe dhunën etnike në Mitrovicë në shkurt të v.2000, kur PSSP, kishte miratuar Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6, e cila siguronte emërimin e një gjykatësi dhe prokurori ndërkombëtar në Mitrovicë.<sup>4</sup> Më 29 maj të v.2000, nën presionin e grevistëve të urisë në Mitrovicë, PSSP, proklamoi Rregulloren 2000/34, e cila zgjeron autorizimet për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në tërë teritorin e Kosovës.<sup>5</sup> Në pajtim me nenin 1(2) të të dy Rregulloreve, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar mund të “zgjedhin dhe marrin përgjegjësi për rastet e reja dhe ato që presin, përbrenda kompetencave të gjykatës për të cilën ai apo ajo janë emëruar.” Në janar të v.2001, autorizimet e prokurorëve ndërkombëtar për të marrë rastet ishte forcuar edhe më tepër me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/2, e cila thotë se: *prokurori ndërkombëtar mund të ndërmarrë, apo vazhdon ndjekjen e rastit duke i përdorur procedurat e aplikueshme për ndjekjen nga ana e palës së dëmtuar, siç parashihet në nenet 60, 61 dhe nenet përkatëse të ligjit jugosllav të procedurës penale. [...]*<sup>6</sup> Sipas këtyre dispozitave të reja, prokurori ndërkombëtar mund të ndërmarrë ndjekjen në rastet kur prokurorët publik vendës konstatojnë se nuk ka baza për këtë, dhe se ata mund gjithashtu të vazhdojnë ndjekjen sipas aktakuzës në gjykata, në rastet kur prokurori publik vendës provon të hedhë poshtë aktakuzën.

Emërimi i personelit ndërkombëtar nëpër gjykata, ka ndihmuar në shmangjen e disa shqetësimeve, por numri i kufizuar i gjykatësve ndërkombëtar, dhe fushëveprimi i kufizuar i autorizimeve, dështon të adresojë në mënyrë adekuate këto brengosje dhe ka rezultuar në trajtimin e ndryshëm të rasteve të ngjashme. Të pandehurit të cilët ishin ngarkuar për krime me motive etnike dhe të peshës së ngjajshme të rëndë, janë gjykuar nga kolegjet e përbërjes së ndryshme. Disa ishin përbëheshin vetëm nga gjykatës shqiptarë të Kosovës, disa tjerë, kishin inkuadruar gjykatësit ndërkombëtar e, në një rast, gjykatësit porot serb të Kosovës.

Për më tepër, kolegjet e gjykatave të qarkut sipas ligjit vendës, duhet të përbëhen prej dy gjykatësve profesional dhe tre gjykatësve porotë.<sup>7</sup> Aktgjykimi merret me shumicë votash dhe çdo gjykatës ka votë të barabartë.<sup>8</sup> Shpërndarja e barabartë e fuqisë votuese tek të gjithë gjykatësit, kishte redukuar shumë çfarëdo ndikimi që gjykatësi ndërkombëtar mund të kishte mbi aktgjykimin potencial të motivuar nga anshmëria etnike. Në këtë drejtim, roli që kishin gjykatësit e parë ndërkombëtar ishte i pamjaftueshëm për sanimin, e së paku, mungesës së paraqitjes objektive të paanshmërisë në gjykimet të cilat përfshinin akuzat për krime të rënda me motive etnike.

<sup>3</sup> Informata për 26 Nëntor 2001, e dhënë në dispozicion nga DD Sekcioni për Zhvillimin Profesional.

<sup>4</sup> Rregullorja 2000/6 *Mbi emërimin dhe Largimin nga Zyra e Gjykatësve dhe Prokurorëve*, 15 Shkurt 2000.

<sup>5</sup> Rregullorja 2000/34 *Ndryshim I Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 Mbi Emërimin dhe Largimin nga Zyra e Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë*, 29 Maj 2000.

<sup>6</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2001/2, Sekcioni 1 (3).

<sup>7</sup> Neni 23 të LPP RFJ.

<sup>8</sup> Neni 116 i LPP RFJ.

Një hap tjetër i mëtejshëm dhe i rëndësishëm, për adresimin e problemit, ishte ndërmarrë më 15 dhjetor të v.2000, me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2000/64.<sup>9</sup> Rregullorja i'u jep prokurorëve kompetent, të akuzuarit apo avokatit të tij, të drejtë për të parashtruar ankesë ndaj vendimit të Departamentit të Drejtësisë (DD) mbi emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar apo ndryshimin e vendgjykimit, kur një gjë e tillë është *“nevojshme për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësisë apo një administrim të drejtë të gjyqësisë.”* Në mungesë të një kërkesë të tillë, DAD, mund të veprojë me vet-iniciativë.<sup>10</sup> Pas parashtrimit të ankesës së tillë, DAD-it i jipet pushteti që të merr në rishqyrtim ankesën në fjalë dhe në bazë të saj t'i bëjë rekomandime PSSP-së, në mënyrë që ai të japë miratimin përfundimtar për sa i përket kësaj ankese apo edhe ta refuzojë atë. Posa të jetë aprovuar kërkesa (ankesa) e tillë, kolegji mund të thirret në përbërje prej një prokurori ndërkombëtar, një gjykatësi hetues, apo të thirret kolegji i cili do të përbëhet nga tre gjykatës, duke përfshirë në përbërjen e saj së paku dy gjykatës ndërkombëtar (“kolegj i gjykatësve nga Rregullorja 64”). Sot, të gjitha rastet më të mëdha apo ato të profilit të lartë, si rregull, gjykohen sipas kolegjit të Rregullores 64 dhe poashtu hetohen dhe ndjeken në pajtim me Rregulloren.

Inkuadrimi i shtuar i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, sidoqoftë, nuk e zgjidh përfundimisht çështjen e mungesës së pjesëmarrjes së minoriteteve në sistemin gjyqësor. Përpjekja e mëtejme për të rekrutuar dhe përfshirë anëtarët e komuniteteve minoritare, posaçërisht të serbëve të Kosovës në sistemin gjyqësor, mbetet çështje e një rëndësie të posaçme. Gjithashtu, duhet të pasur parasysh se përderisa ekzistimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë mund të jetë i mjaftueshëm për të larguar dyshimin mbi anshmërinë në rastet e profilit të lartë në nivelin e Gjykatave të Qarkut, në Gjykatat dhe ato për Kundërvajtje Komunale, nuk ka pjesëmarrje ndërkombëtare në administrimin e gjyqësisë. Pra, ndërtimi i sistemit gjyqësor multietnik është një *“sine qua non”* për ndërtimin e një mjedisi institucional, i cili qeveriset nga parimet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës dhe i cili inspiron besimin tek të gjithë anëtarët e komunitetit. Përfundimisht, ndërmarrja e veprimeve afirmuese drejt këtij qëllimi, paraqet një zgjidhje për adresimin e çështjes së të kthyerve. Në këtë drejtim, UNMIK-u duhet të përqëndroj iniciativat për kthim në profesionistët, të cilët, janë anëtarë të komuniteteve minoritare në Kosovë, dhe të cilët mund të shërbejnë si bazë për një besim të qëndrueshëm dhe përpjekje për zhvillimin kadrovik brenda komuniteteve minoritare.

### *Struktura paralele gjyqësore*

Që nga viti 1999, një strukturë paralele gjykatash, të përgjegjshme ndaj Beogradit, e jo ndaj UNMIK-ut, ka vazhduar të ekzistoj në pjesët veriore të Kosovës, të dominuara nga serbët e Kosovës.<sup>11</sup> Gjatë vitit 2001, UNMIK-u ka vazhduar të diskutoj me zyrtarët e RFJ punën e përbashkët për formimin e një sistemi gjyqësor multietnik, dhe eliminimin e sistemeve paralele. Më parë, zyrtarët e RFJ nuk ishin pajtuar, pasi që marrëveshja për të

<sup>9</sup> Për diskutim të mëtejme përkitazi me Rregulloren 2000/64, shiko Raportin e Dytë të OSBE mbi Sistemin Gjyqësor Penal, 1 Shtator 2000-28 Shkurt 2001, f. 77 ff.

<sup>10</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, seksioni 1(2).

<sup>11</sup> Shiko më tej Raportin e OSBE-së mbi Aktivitetin Paralel Gjyqësor në Kosovën Veriore.

ndërtuar një gjyqësi multi-etnike mund gjithashtu të nënkuptoj, mes tjerash, pranimin e Kornizës Kushtetuese.<sup>12</sup>

Në këtë drejtim, Dokumenti i Përbashkët UNMIK-Jugosllavi, i datës 5 nëntor të v.2001, paraqet një hap përpara që konfirmon veprimtarinë e UNMIK-ut për të krijuar një gjyqësi multi-etnike në Kosovë dhe marrëveshje që të marrë në konsiderim emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve serb të Kosovës në gjyqësinë e Kosovës.<sup>13</sup>

Sidoqoftë, përkundër veprimtarisë politike të arritjes së zgjidhjeve për strukturat gjyqësore paralele në pjesën veriore të Kosovës, realiteti ekzistues provon të kundërtën.

Një gjykim që ende është në rrjedhë e sipër në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë ka shtruar shqetësime të reja të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe qartë tregon se pikëpamjet e forta mbi strukturën paralele janë ende shumë larg për tu mënjanuar. Një serb i Kosovës që banonte në një fshat në komunën e Zubin Potokut, ishte akuzuar dhe gjykuar për një vrasje të raportuar nga Gjykata e Qarkut në Kraljevë (teritor i Serbisë), pasi që kjo e fundit kishte prezumuar kompetencën territoriale të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.<sup>14</sup> Pasi që ishte gjykuar dhe liruar nga gjykata e kaluar, i pandehuri ishte akuzuar për të njëjtën veprë nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë më 23 gusht të v.2001 e më vonë paraburgosur sipas urdhërit të të njëjtës gjykatë më 30 gusht të v.2001. Ndonëse vendimi i Gjykatës së Qarkut në Kraljevë nuk është përfundimtar dhe ankesa pret në Gjykatën Supreme të Serbisë, pra nuk shtron aplikueshmërinë e nenit 14(7) të KNDCP,<sup>15</sup> SMSL shtron shqetësimet përkitazi me situatën e rrezikut të dyfishtë për të pandehurin. Sipas punimeve të seancës fillestare të gjykimit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, provat e parashtruara nga prokuroria janë identike me provat e administruara gjatë gjykimit të parë. I pandehuri dha të njëjtën dëshmi sikurse para Gjykatës së Qarkut në Kraljevë, e pritët që edhe dëshmitarët ta bëjnë të njëjtën.

## Mungesa e personelit në gjykata

### *Gjykatësit dhe prokurorët vendës*

Përveç mungesës së pjesëmarrjes së gjykatësve dhe prokurorëve nga grupet minoritare në sistemin gjyqësor të Kosovës, gjykatat vendëse edhe në të gjitha nivelet tjera në Kosovë kanë mungesë gjykatësish dhe prokurorësh. Siç u përmend më lart, buxheti i Kosovës parasheh emërimin e 420 gjykatësve dhe prokurorëve të emëruar dhe që punojnë në 55 gjykatat e Kosovës, por tani për tani, janë të hapura edhe 80 vende.<sup>16</sup> Pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/64, gjithashtu është rritur në mënyrë të theksueshme edhe norma e punës për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar dhe ka rezultuar në nevojën për të emëruar më tepër ndërkombëtarë në gjyqësi dhe zyra të prokurorisë.

<sup>12</sup> Raporti Javor i OMIK Nr. 34/2001.

<sup>13</sup> Vazhdimisht i referuar si Dokumenti I Përbashkët.

<sup>14</sup> Për më tepër detaje, shiko Raportin e OSBE mbi Aktivitetin Paralel të Gjykatave në Kosovën Veriore.

<sup>15</sup> Neni 14 (7) KNDCP dhe Neni 4 i Protokolit 7 të KEDNJ përmbajnë ndalesën kundër rrezikut të dyfishtë (të njohur gjithashtu edhe si parimi i *ne bis in idem*), duke thënë se asnjëri nuk do të përgjigjet apo dënohet për veprën për të cilën njëherë përfundimisht është dënuar apo liruar.

<sup>16</sup> Informatat të bazuara në statistikat valide për Janar 2001.



Ekziston edhe mungesa e personelit ndihmës si brenda gjykatave ashtu edhe brenda Divizionit të Përkrahjes Ndërkombëtare Gjyqësore.

Në regjionin e Gjilanit, Kryetari i Gjykatës së Qarkut raporton mbi mungesën e dy gjykatësve për dëgjimin e lëndëve civile. Kryetari i Gjykatës Komunale raporton se janë të zbrazëta tri vende për gjykatës dhe së paku katër vende për personelin ndihmës. Kryetari i Gjykatës për Kundërvajtje raporton se ekziston nevoja edhe për katër gjykatës dhe një numër (12) personelit ndihmës.<sup>17</sup>

Në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, është konkursi për katër vende gjyqësore. Nga katër gjykatësit e mbetur (përfshirë edhe kryetarin e Gjykatës), është vetëm një gjykatës gjykues përderisa dy gjykatësit tjerë veprojnë edhe si gjykatës hetues në lëndët penale edhe si gjykatës civilist. Sipas informatave të mbledhura nga SMSL, gjykatësi i mbetur gjykues do të jap dorëheqje. Më 15 Nëntor 2001, Kryetari i Gjykatës së Qarkut deklaroi se si çështje e parimit, vetëm rastet urgjente përkitazi me paraburgimin ishin dëgjuar por nuk janë caktuar gjykime për shkak të mungesës së gjykatësve. Nga katër vendet për prokuror vetëm tri janë të plotësuara.<sup>18</sup>

Sipas Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, janë 24 poste për gjykatësa të vendosur për këtë gjykatë por vetëm 14 janë të plotësuara tani për tani (prej të cilëve njëri është deleguar në Institutin Gjyqësor të Kosovës).<sup>19</sup>

Përkitazi me mungesën e gjykatësve dhe prokurorëve vendës, çështja e pagesave është një pengesë e madhe për gjetjen e personave kompetent për plotësimin e këtyre vendeve. Përderisa është e kuptueshme se kjo është vetëm për shkak të buxhetit të kufizuar, duhet pasur parasysh se, me qëllim të sigurimit të një gjyqësie dhe zyrave të prokurorisë të pavarura dhe të kualifikuara mirë, të ardhurat duhet të jenë të krahasueshme me të ardhurat që këta profesionistë mund t'i fitojnë jashtë gjyqësisë. Kur rritja në pagesa nuk mund të bëhet për shkak të kufizimeve në buxhet, pagesat ekzistuese duhet të shtohen përshtatshëmrisht me shkallën e logjikshme që i jep profesionalistit një shkallë më të lartë të të ardhurave se sa personelit ndihmës të tyre. Mospërputhjet në mes të kategorive të të punësuarve varësisht se a janë paguar nga BKK apo nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare apo agjencive, janë bërë çështje simptomatike në shoqërinë e Kosovës dhe vazhdimi i kësaj mund të shpije drejt konfliktit apo devijimit social.

Sipas aranzhimeve të tanishme të kuadrove në gjyqësi, pozitat ekzistuese paguhen prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK). Megjithate, ka situata ku personeli plotësues ndihmës për disa gjykata, ishin punësuar sipas buxhetit të UNMIK-ut dhe, pasueshëm, pranojnë të ardhura në një nivel shumë më të lartë. Si rezultat, paraqiten ndasi të theksueshme në mes të nivelit të pagesave të disa nga personeli ndihmës nëpër gjykata, të cilët janë të paguar nga UNMIK-u, dhe gjykatësve dhe prokurorëve të cilët janë të paguar nga BKK.

Përveç problemeve që i krijon për anëtarët e vet gjyqësisë, siç është numri i lëndëve dhe vëllimi i madh i punëve, mungesa e numrit të mjaftueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve

---

<sup>17</sup> Informatat e mbledhura kah fundi i vitit 2001.

<sup>18</sup> *Ibidem.*

<sup>19</sup> *Ibidem.*

gjithashtu ndikon shumë mbi të drejtat e individëve, rastet e të cilëve janë në duart e gjyqësisë. Pamjaftueshmëria e numrit të zyrtarëve gjyqësor shpije deri te zvarritjet në procedimin e rasteve, madje edhe në instancat ku çështja e një lënde të caktuar mund të kërkoj një kohë të shkurtë dhe burime minimale për t'u zgjidhur. Për më tepër, dimenzioni i të drejtave të njeriut të kësaj rrjedhe administrative keqësohet kur i pandehuri i cili pret gjykimin, gjindet në paraburgim. SMSL, ka dokumentuar raste të shumta ku të pandehurit kanë kaluar një vit apo më tepër në paraburgim para se të sillleshin në gjykim. Në shumë nga këto raste, nuk kishte pasur veprime të theksueshme hetimore të ndërmarra gjatë këtyre periudhave të gjata kohore para gjykimit.

Shembulli më i freskët për këtë çështje, është rasti i dy të pandehurve serb të Kosovës, të dyshuar për vjedhje të rëndë dhe plaçkitje, të paraburgosur në Mitrovicë që nga 27 tetori i v.2000, në të cilën datë ishin inicuar hetimet kundër tyre. Në mes të kësaj date dhe 12 dhjetorit disa veprime hetimore janë ndërmarrë kundër të dyshuarve por pas kësaj nuk janë ndërmarrë veprime të mëtutjeshme hetimore. Shkaku i ofruar për këtë ishte se të gjithë dëshmitarët e plaçkitjes së armatosur ishin në Maqedoni dhe përkundër disa kërkesave përmes Departamentit Administrativ të Drejtësisë, për të dëgjuar dëshmitarët në Maqedoni, nuk kishte ndonjë përgjigje. Përkundër mungesës së dukshme të provave lidhur me këtë rast, megjithate, të dy të paraburgosurit së bashku me tre të dyshimtë (të pa-paraburgosur) lidhur me rastin, ishin akuzuar më 3 tetor të v.2001, bazuar vetëm në provat që ishin në dispozicion në gjykatë që nga 12 dhjetori i v.2000.

Përveç aspektit të pastër administrativ të çështjes përkitazi me mungesën e gjykatësve dhe prokurorëve, SMSL, është gjithashtu i shqetësuar me mënyrën se si shkelen të drejtat themelore të individëve që ballafaqohen me sistemin gjyqësor. Kur nuk ka alternativa objektive të vendosura për plotësimin e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve, SMSL konsideron se ekzistojnë alternativa tjera dhe mjete juridike të cilat mundën dhe duhet të aplikohen. Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka konstatuar se e drejta në gjykim brenda një kohe të arsyeshme, duhet të interpretohet në dritë të prezumimit të pafajsisë. Gjykata e sipërpërmendur ka bërë të qartë se, gjykatat vendëse janë ato të cilat duhet të konstatojnë se a ishte tejkaluar kufizimi kohorë i arsyeshëm deri në pruarjen e aktgjykimit, p.sh, se a ka imponuar një sakrificë më të madhe që mundet, në rrethanat e rastit, që të pritët që personi në mënyrë të arsyeshme të **prezumohet i pafajshëm**<sup>20</sup>

Ligji vendës i aplikueshëm në Kosovë, parasheh periudhën maksimale prej 6 muajve brenda të cilit duhet të ngritet aktakuza, me obligimin për lirim të të paraburgosurit kur të skadoj afati kohor.<sup>21</sup> Andaj, këtu ekzistonte një afat kohor i definuar, e i themeluar me ligj, pas të cilit, e drejta në liri dhe në prezumim të pafajsisë ishte konsideruar si më e vlefshme se çdo interes tjetër. Pa marrë parasysh, afati i përmendur kohor ishte ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/26, i cili e rriti afatin kohor të ngritjes së aktakuzës nga 6 muaj në një vit, në kohën kur sistemi gjyqësor ishte në fazë të tillë fillestare që objektivisht, nuk do të mundte, të kryente lëndët brenda afatit kohor të paraparë me ligj. Megjithate, është e njohur se faza emergjente për gjyqësinë ka përfunduar dhe si pasojë, duhet të ri-fuqizohen standarde dhe garanca më të larta me qëllim të ofrimit të një niveli

<sup>20</sup> *Ēemhoff v. Germany*, KEDNJ 27 Qershor 1968.

<sup>21</sup> Neni 192 LPP RFJ.

të pranueshëm të mbrojtjes së të drejtave themelore të personave që janë objekt i të drejtës penale.

SMSL, gjithashtu ka shfaqur shqetësimet përkitazi me implikimet tjera në raport me mungesën e personelit të gjykatave. Ka patur instanca kur gjykatësit e Gjykatave Komunale prej rastit në rast, ishin caktuar për të ushtruar detyrat e Gjykatave të Qarkut, dhe gjithashtu ka pasur instanca kur lëndët nën kompetencën e Gjykatës së Qarkut ishin zhvilluar nga gjykatësit e Gjykatave Komunale, madje edhe pa emërimin apo autorizimin formal. Këto aspekte janë shqetësuese për SMSL nga perspektiva e të drejtës së të pandehurit që të gjykohet nga gjykata kompetente. Ky parim nënkupton që gjykatësit në kolegjin gjykues, përveç derogimit formal të kompetencës me caktimin e tyre në kolegjin përkatës, duhet të kenë edhe ekspertizë për të shqyrtuar në mënyrë të drejtë çështjen e lëndës në fjalë. Për më tepër, SMSL ka vërejtur rastet kur vendimet e marra gabimisht nga gjykatësi i gjykatës më të ulët, kanë ndikuar në procedurë apo në rezultatin e rastit kur i njëjti më vonë është zhvilluar nga gjykata kompetente më e lartë.

Për shkak të mungesës serioze të personelit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, ishte konstituuar ngadalë praktika e përdorimit të gjykatësve të Gjykatës Komunale në rastet e Gjykatës së Qarkut. Derisa ishte e dukshme se caktimi i rregullt i gjykimeve, nuk mund të bëhet në këtë Gjykatë me vetëm një gjykatës gjykues, zgjidhja e përdorimit të gjykatësve të gjykatave më të ulta që të marrin pjesë në zgjidhjen e rasteve senzitive dhe të rëndësishme, duhej të ishte e përkohshme. Departamenti i Drejtësisë (DD)<sup>22</sup> si çështje të urgjencës mund të kishte ndërmarrë emërim apo caktime të reja dhe të përkohshme të gjykatësve. Situata u keqësua me 28 shtator të v.2001 kur Kryetari i Gjykatës së Qarkut vendosi që të mos caktoj më gjykime, përpos ato me të pandehur të paraburgosur, derisa u gjet zgjidhja nga DD për të plotësuar vendet e zbrazëta për gjykatës. Kjo formë e protestës e adoptuar nga Kryetari qoi kah krijimi i një vëllimi të madh serioz të lëndëve në këtë gjykatë, dhe, më e rëndësishmja, shtroi shqetësime serioze të mohimit të drejtësisë ndaj individëve të cilët kanë të drejtë që tu caktohen gjykimet brenda një kohe të arsyeshme.

Një i dyshimtë shqiptar i Kosovës ishte arrestuar dhe akuzuar në mars 2000 për dhunim të raportuar të një vajze 13-të vjeqare dhe vjedhjen e 50 DM. Gjykatësi i Gjykatës së Qarkut inicioi hetimet formale, dhe si pasojë, caktoi paraburgimin. Sidoqoftë, gjykatësi i Gjykatës Komunale, i cili gjithashtu inicioi hetimet në akuzat e vjedhjes, kërkoi dhe muar shkresat e lëndës së Gjykatës së Qarkut. Pas veprimeve të shkurtëra hetimore, ai urdhëroi lirimin e të dyshuarit dy muaj pas arrestimit fillestar dhe para dërgimit të shkresave të lëndës prapa në Gjykatën e Qarkut për zhvillimin e hetimeve të rregullta mbi akuzat e dhunimit. Rrjedha e procedurës në mënyrë serioze ishte ndikuar nga vendimi për lirimin e të dyshuarit. Aktakuza ishte ngritur në shkurt 2001 dhe data e gjykimit të parë ishte caktuar për 13 mars 2001. Megjithatë, i pandehuri asnjëherë nuk u paraqit, as para gjykatësit hetues e as para gjykatës, dhe gjykimi gjer më sot, në mënyrë përsëritëse është shtyer për shkak të mungesës së të pandehurit.

---

<sup>22</sup> Departamenti i Drejtësisë (DD) ishte, brenda kornizë-punës së re të Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut, vazhdues i Departamentit Administrativ të Drejtësisë.

### *Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar*

Shqetësime të ngjashme mbi vonesën në ndarjen e drejtësisë në kohë të arsyeshme për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve gjyqësor paraqitet gjithashtu edhe në rastet e zhvilluara nga gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar. Pasiqë të gjitha rastet e mëdha gjykohen nga kolegjet e themeluara sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, përfshirë, si rregull, dy gjykatës ndërkombëtar dhe një vendor, dhe të ndjekur nga një prokuror ndërkombëtar, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar janë vazhdimisht të stërngarkuar rëndë me punë. Rezultati është sërish dëmtues të shumtën për të drejtat e të pandehurit, posaqërisht kur është i urdhëruar paraburgimi para-gjyqësor.

Një serb i Kosovës, fillimisht i ngarkuar për krime lufte në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë ishte arrestuar më 20 dhjetor 1999. Aktakuza ishte ngritur më 8 shtator 2000 por gjykimi – i cili ishte mbajtur para kolegjit nga Rregullorja 64 në përbërje prej dy ndërkombëtarëve dhe një gjykatësi vendor, dhe një prokurori ndërkombëtar – nuk filloi deri më 10 prill 2001.<sup>23</sup> Ishte bërë përpjekje që gjykimi të filloi më 22 janar 2001 para kolegjit të rregullt gjykues që kishte një gjykatës ndërkombëtar por gjykimi ishte shtyrë në pritje të veprimit të DAD për kolegjin nga Rregullorja 64. Pas ditës së parë të gjykimit më 10 prill, seanca kryesore ishte shtyrë për më tepër se 30 ditë. Më 24 maj gjykimi kishte rifilluar para kolegjit të ri pasi që një gjykatës ndërkombëtar kishte lëshuar misionin e ligji i aplikueshëm kërkon që kurdo që përbërja e kolegjit do të ndryshoj, gjykimi duhet të filloj prej fillimit.<sup>24</sup> Me 30 korrik, pasi që aktakuza ishte ndryshuar dhe akuzat redukuar në shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, shkaktim dëmi dhe vjedhje të rëndë, i akuzuari ishte liruar me dorëzani pas 18 muajsh paraburgimi. Përgjithësisht gjykimi ishte zhvilluar shumë ngadalë me disa shtyerje të gjata dhe me 5 nëntor, d.m.th. pas gati 7 muajsh pas fillimit të seancës kryesore, gjykimi nuk kishte lëvizur më tej se nga dëgjimi i dëshmitarit të dytë. Në janar 2002, gjykimi në shkallën e parë përfundoi me lirim e të pandehurit.

Dy serb të Kosovës ishin arrestuar në regjionin e Prizrenit më 31 janar 2000 nën dyshimin e kryerjes së krimeve të luftës. Rasti ishte nën hetime nga gjykatësi vendor hetues. Më 19 janar 2001, prokurori ndërkombëtar ishte emëruar për këtë rast sipa Rregullores 64. Më 31 janar 2001 ka skaduar periudha e maksimumit kohor të paraburgimit.<sup>25</sup> Të dyshuarit megjithatë nuk ishin liruar. Më 7 shkurt 2001 Gjykata e Qarkut në Prizren pranoi aktakuzën e cila, në pajtim me ligjin, ishte pas-datuar prej 1 shkurtit. Të dyshuarit ishin ngarkuar për pjesëmarrje për kryerje të dhunës, paraburgim të paligjshëm dhe lëndime të rënda trupore. Më 12 shkurt 2001, akuzat për krime lufte ishin hedhur poshtë. Më 16 tetor 2001, gjykimi më në fund u zhvillua d.m.th. pas më tepër se 20 muajsh pas arrestimit dhe më tepër se 7 muajsh pas ngritjes së aktakuzës. Më 18 tetor 2001, të dy të pandehurit ishin liruar me dorëzani dhe më 2 nëntor 2001, të dy ishin shpallur të pafajshëm për shkak të mungesës së provave.

SMSL konsideron se ky rast i veçantë, ku dy të pandehurit kaluan 20 muaj në paraburgim para se të ishin sjellur në gjykim, është shkelje e standardit të arsyeshmërisë sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Komisioni për të drejtat e njeriut e asamblesë së

---

<sup>23</sup> Neni 280 (2) LPP RFJ thotë se gjykimi kryesor do të caktohet jo më vonë se dy muaj nga data e pranimit të aktakuzës në gjykatë.

<sup>24</sup> Neni 305 (3) LPP RFJ.

<sup>25</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/26 ka zgjatur maksimumin e paraburgimit para-gjyqësor për personat e dyshuar për kriminalitet serioz deri në një vit (Sekcioni 1). Sipas Sekcionit 2, nëse aktakuza nuk është ngritur brenda kësaj periudhe, i dyshuari është liruar

përgjithshme të Kombeve të Bashkuara<sup>26</sup> konkludoi, në një rast të vrasjes kapitale, se mbajtja e personit për 16 muaj para gjyqimit në mungesë të shpjegimeve të kënaqshme nga autoritetet shtetërore apo arsytetimeve tjera që rrjedhin nga dosja, ishte shkelje e të drejtave të personit që të gjykohe brenda afatit të arsyeshëm kohor apo të lirohet.<sup>27</sup>

Në një mënyrë, DAD kishte (dhe DD ende) po adreson numrin e pamjaftueshëm të gjykatësve ndërkombëtarë në secilin regjion duke themeluar kolegje në përbërje prej gjykatësish nga regjionet e ndryshme. Situata gradualisht vie duke u rënduar, dhe si rezultat i kësaj është lëvizja e gjykatësve nga një regjion në tjetrin dhe nga një kolegji në tjetrin. Ka instanca kur gjykatësit të cilët ulëshin në kolegje në një rast nuk kishin raste të takoheshin prap dhe të votonin mbi aktgjykimin.

Në rastin e tre shqiptarëve të Kosovës të dënuar me 6 prill 2001 për organizim apo pjesëmarrje në grupin kriminel, tentim-shtrëngimi dhe kidnapim, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe rrezikim të jetës së njerëzve, kolegji i Gjykatës Supreme në përbërje prej tre gjykatësish ndërkombëtar shqyrtuan ankesën më 29 gusht 2001. Prej asaj dite e gjer më sot, ende pritet vendimi mbi ankesën dhe njëri shkak për vonesën ishte, sipas dijenisë së SMSL, fakti se të tre gjykatësit në kolegji nuk kishin qenë në gjendje që për një kohë të gjatë të mbledhen dhe votojnë për aktgjykimin.

Përderisa këto mangësi në administrimin e gjyqësisë kryesisht i referohen mungesës së personelit të mjaftueshëm për mbulimin e vëllimit të madh të rasteve për të cilët ata janë caktuar, SMSL është i shqetësuar me efektin e këtyre çështjeve administrative në të drejtat substanciale të të pandehurve. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, të drejtat e të pandehurve që të gjykohen brenda një afati të arsyeshëm kohor, siq parashihet në nenin 6(1) të KEDNJ dhe nenin 14 (3) (c) të KNDCP, ishin të parespektuara. Gjykata Evropiane mbante qëndrimin se qëllimi i standardeve që kërkojnë që gjykimet të mbahen mbrenda kohës së arsyeshme është për të siguruar që njerëzit që presin gjykimin sipas akuzave penale, të mos pësojnë pasiguri të prolonguar dhe të padrejtë. Kur janë në paraburgim, standardet e imponuara mbi autoritetet shtetërore janë madje edhe më të larta, pasi që bazohen në prezumimin e pafajsisë dhe të drejtën në lirinë personale. Ky standard kërkon që secili person i paraburgosur ka të drejtë që rasti i tij të ketë prioritet dhe që procedura të zhvillohet me ekspeditivitet të veçantë.<sup>28</sup>

Ishte marrë vendimi që të dyfishohet numri i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar deri në maj 2002<sup>29</sup> dhe procedura e rekrutimit është në vijim e sipër, por në ndërkohë ky problem mbetet si pengesë kryesore për administrimin e duhur të gjyqësisë. Në lidhje me këtë, ekziston gjithashtu edhe mungesa e zyrtarëve ligjor vendës dhe ndërkombëtarë, interpretëve, nëpunësve, dhe personelit tjetër të domosdoshëm për funksionimin e mbarë të sistemit gjyqësor.

---

<sup>26</sup> Në tekstin e mëtejshëm, Komiteti për të Drejtat e Njeriut.

<sup>27</sup> Shiko, *Mc Laërence v. Jamaika*, Komisioni Ndër-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut, 29 Shtator 1997.

<sup>28</sup> Shiko *Abdoella v. Holanda*, KEDNJ 25 Nëntor 1992, dhe *Tomasi v. Franca*, KEDNJ 27 Gusht 1992.

<sup>29</sup> Dokumenti i Përbashkët UNMIK-Jugosllavi, 5 Nëntor 2001, Gjyqësia.

### *Dështimi për të paguar gjykatësit porotë dhe ekspertët gjyqësor*

Edhe pse është çështje e brendshme në mes të gjykatave dhe administruesve të tyre, çështja e pagesës së të ardhurave të duhura apo honorareve për gjykatësit porotë dhe ekspertët gjyqësor, në disa raste kishte rezultuar me probleme substanciale në procedimin e rasteve në fazën hetimore apo edhe në gjykim.

Në Gjykatën Komunale në Gjilan, në tetor të v.2001, kishte ndodhur një grevë, pasi që gjykatësit porotë refuzuan të punojnë për shkak të faktit se DAD, nuk i kishte paguar të ardhurat e tyre. Refuzimi i gjykatësve porotë grevist që të ulen në kolegjet gjyqësore rezultoi në paralizën e përkohshme të aktiviteteve të gjykatës.

Protesta të ngjashme ishin organizuar në disa raste nga ekspertët forenzik në regjione të ndryshme. Gjykimet zvarriteshin vazhdimisht duke u shtyrë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë gjatë periudhës prej dy muajsh nga fundi i janarit gjer në mars të v.2001, për shkak të refuzimit të ekspertëve forenzik për të dhënë raporte të kërkuara nga gjykata derisa kërkesat e tyre financiare të mos plotësoheshin. Refuzime të ngjashme ishin dokumentuar në disa raste individuale në regjionin e Prizrenit. Kur janë pyetur që të identifikojnë fluksin administrativ që ndikon në punën e tyre, shumica e Kryetarëve të Gjykatave të Qarkut dhe atyre Komunale i treguan SMSL, se është një refuzim – kuazi - i përgjithshëm i ekspertëve forenzik për t'u paraqitur në gjykata dhe për të ofruar ekspertizat e tyre në lëndët penale. Ky refuzim gjithmonë ishte arsyetuar me pagesat e ulëta apo të vonuara për shërbimet e tyre.

Këto situata kanë ngritur shqetësime për shkak të ndikimit që kanë ato në të drejtën e të pandehurve që të gjykohen brenda një kohe të arsyeshme.

### **Dërgimi i dokumenteve gjyqësore**

Dërgimi i dokumenteve gjyqësore është një aktivitet tjetër administrativ i autoriteteve gjyqësore, i cili, nëse bëhet në mënyrë të duhur, nuk do të ndikoj në të drejtat substanciale të të pandehurve të cilët janë objekt i procesit gjyqësor. Qarkullimi masiv i dokumenteve, siç janë, fletë-thirrjet, aktgjykimet dhe urdhërat për paraburgim, gjer dhe nga gjykatat, dhe metodat e dërgimit, ishin çështje e shqetësimit për SMSL. Jokonsistenca në praktikë mund të ndikoj negativisht në përpjekjet e gjykatave për të arritur standardet e procesit të rregullt dhe gjykimin të drejtë.

### *Dërgimi i aktgjykimeve*

Mënyra dhe afati i dërgimit të aktgjykimeve tek palët, për lëndët penale, ka një rëndësi të veçantë, pasi që, ligji i aplikueshëm, e obligon ushtrimin e të drejtës së ankesës kundër vendimit gjyqësor deri në momentin kur vendimi i shkruar gjyqësor/aktgjykimi arrin te palët. SMSL ka shprehur brengosje lidhur me çështjen e dërgimit të aktgjykimeve të lëndëve penale, posaçërisht në ato raste kur të pandehurit ishin të paraburgosur dhe zvarritja në pranimin e aktgjykimit, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ndikonte në të drejtën e tyre që vendimi të rishqyrtohet nga një gjykatë më e lartë, dhe mundësisht, të drejtën e tyre të lirisë. Kur zvarritjet ishin të theksueshme, SMSL, theksoi këto lëshime administrative gjithashtu nga perspektiva e të drejtës së të pandehurve që të gjykohet

brenda kohës së arsyeshme. Në raportin e Komisionit për të drejtat e njeriut, ishte pohuar se, e drejta për tu gjykuar brenda kohës së arsyeshme përfshin të drejtën për të pranuar vendimin e arsyetuar, në gjykim dhe sipas ankesës, brenda një kohe të arsyeshme. Komisioni më tej mbajti qëndrim se, dështimi i gjykatës për të parashtruar një aktgjykim të arsyetuar me shkrim, brenda një kohe të arsyeshme, ka ndikuar që i pandehuri të pengohet në ushtrimin e të drejtës së tij/saj të cilën e gëzon, për rishqyrtimin e dënimit të shpallur kundër tij/saj, para gjykatës së shkallës më të lartë.<sup>30</sup>

Ligji i aplikueshëm thotë se aktgjykimi me shkrim duhet të përpilohet brenda 8 ditësh pas shpalljes së tij apo, në rastet e ndërlikuara edhe brenda 15 ditësh. Nëse aktgjykimi nuk përpilohet brenda afatit të paraparë, kryetari i kolegjit ka për detyrë që të informoj kryetarin e gjykatës përkatëse përkitazi me shkaqet e vonesës dhe përfundimisht, nga kryetari kërkohet që të ndërmarrë masa të nevojshme që të siguroj se aktgjykimi do të jetë i përpiluar sa më shpejtë që është e mundur.<sup>31</sup> Sa i përket dërgimit të aktgjykimit me shkrim, ajo gjithashtu mbetet përgjegjësi e gjykatës. Kur i pandehuri është në paraburgim, dërgimi duhet të bëhet brenda afatit të njëjtë kohor si për përpilimin e aktgjykimit.<sup>32</sup> Për më tepër, ligji thotë se e drejta për të parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, do të ushtrohet brenda 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi është dërguar.<sup>33</sup>

Rrjedhimisht, është obligim i gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës që të sigurojnë që aktgjykimet të jenë të përpiluara dhe dërguara me kohë palëve përkatëse ashtu siç e parasheh edhe ligji. Dështimi ose i gjykatësit përgjegjës ose i kryetarit të gjykatës përkatëse, që të veprojnë në pajtim me obligimet e tyre profesionale rezulton në shkeljen e të drejtave të palëve për të parashtruar ankesë kundër aktgjykimit në fjalë. SMSL ka dokumentuar vonesa serioze në dërgimin e aktgjykimeve me shkrim të pandehurve . Në fakt, duket se ekziston një trend në kuadër të disa Gjykatave të Qarkut, përkitazi me dërgimin e aktgjykimeve brenda afatit kohor prej një muaji në vend se brenda disa ditëve ashtu siç parashihet me ligj.

SMSL mblodhi të dhëna statistikore për periudhën kohore ndërmjet përfundimit të seancës kryesore dhe dërgimit të aktgjykimeve të shkruara. Përderisa në Gjykatat Komunale duket se dërgimi i aktgjykimeve bëhet, si rregull, brenda afatit ligjor, aktgjykimet e Gjykatave të Qarkut shpeshherë lëshohen me vonesë të theksueshme.

SMSL, ka analizuar të dhënat statistikore përkitazi me dërgimin e aktgjykimeve të shkruara në dy Gjykata të Qarkut, Mitrovicë dhe Gjilan. SMSL ka dokumentuar se në 25 rastet prej 36 të monitoruara, në Mitrovicë në vitin 2000, aktgjykimet ishin dërguar me vonesë prej 1 deri në 8 muaj. Vonesat deri në 5 muaj ishin vërejtur në lëndët e zhvilluara gjatë vitit 2001. Në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, prej lëndëve të zhvilluara nga gjykata në vitin 2000, në 49 prej 72 lëndëve në fjalë aktgjykimet ishin dërguar me vonesë prej 1 deri në 7 muaj. Si vërejtje pozitive mund të merret edhe se gjykata e njëjtë arriti të

---

<sup>30</sup> Shiko Raportin e KDNJ në rastin *Currie v. Jamajka*, 29 Mars 1994.

<sup>31</sup> Neni 356 (1) LPP RFJ.

<sup>32</sup> Neni 356 (3) LPP RFJ.

<sup>33</sup> Neni 356 (1) LPP RFJ.

përmirësoj namin këtë trend duke i dërguar vetëm 6 aktgjykime prej gjithsejt 67 me vonesë prej një muaji.

Ekziston një numër i kufizuar i lëndëve kur vonesat në dërgimin e aktgjykimeve rezultuan me shkeljen e të drejtave të të pandehurve të cilën gjë e parasheh edhe ligji ndërkombëtar.

Në dy lëndë të zhvilluara në Gjykatën e Qarkut në Prizren, SMSL ka dokumentuar vonesat për më tepër se 14 muaj në dërgimin e aktgjykimeve me shkrim. Në të dyja këto lëndë të pandehurit ishin në paraburgim dhe e drejta e tyre për ankesë ishte mohuar nga fakti se atyre nuk u është dorëzuar aktgjykimi me shkrim. Përkundër disa ankimeve nga avokatët mbrojtës dhe madje prokurorit publik i cili ishte i kyqur në njërin prej rasteve, nuk ishte ndërmarrë asnjë masë nga ana e kryetarit të gjykatës, siç kërkohet edhe nga ligji i aplikueshëm, për të përshpejtuar dërgimin e aktgjykimeve.

#### *Dërgimi i urdhërave gjyqësor për të liruar apo paraburgosur*

Çështja e përpilimit dhe dërgimit të urdhërave gjyqësor për të paraburgosur personin e dyshuar për përfshirjen e tij në kryerjen e veprës penale apo për të liruar personin nga paraburgimi ka qenë një brengë e veçantë për SMSL-në në të kaluarën. Ekziston një numër i rasteve ku dërgimi i parregullt apo jo me kohë i këtyre dokumenteve ka rezultuar me lirime të gabuara të të dyshuarve ose me paraburgim të paligjshëm të personave që është dashur të lirohen.

Në këtë drejtim, SMSL-ja ka vërejtur se një pjesë e organeve gjyqësore janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të normalizuar këtë gjendje nëpër gjykata dhe, si rregull, urdhërat për lirim apo paraburgim vazhdimisht janë përpiluar dhe dërguar në mënyrë të rregullt në objektet e paraburgimit. Sipas informatës interne të lëshuar në qarkullim në kuadër të UNMIK-ut, është duke u përgatitur një qarkore të cilën pritet ta lëshoj DD-ja e cila do t'i përkujtonte të gjithë gjyqtarët si ata vendës ashtu edhe ata ndërkombëtar në lidhje me domosdoshmërinë që gjyqtarët t'u përmbahen procedurave ligjore dhe afateve kohore sidomos gjatë dhënies së urdhërave qoftë për paraburgim apo edhe për lirim. Iniciativat e tilla janë të përkrahura dhe inkurajuar në mënyrë të fuqishme.

SMSL, megjithatë, është e shqetësuar me ato raste kur gjykatat ende dështojnë t'i përmbushin obligimet e tyre në pajtim me kërkesat ligjore, pasi që ato paraqiten në frymë të përpjekjeve të qarta të gjykatësve dhe administratës gjyqësore për të adresuar dhe për të gjetur zgjidhje efikase për këto mangësi. Ndonëse të kufizuar në numër, rastet e tilla ngrisin shqetësimin përkitazi me të drejtën e të dyshuarit për liri pas lirimimit me urdhër të gjykatës kompetente, ose me interesin që kanë autoritetet për të mbajtur të dyshuarin në paraburgim kur kjo të konsiderohet e domosdoshme për kryerjen e hetimeve të duhura.

Në një rast të hetuar në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe e cila i është caktuar një gjykatësi dhe prokurori ndërkombëtar, një i dyshuar shqiptar i Kosovës ishte arrestuar, siç pohohet, për shkak të përfshirjes së tij në kryerjen e veprës penale të vrasjes. Pas shqyrtimit *prima facie* të provave në këtë rast, gjykatësi hetues ndërkombëtar vendosi se nuk kishte baza të mjaftueshme për të paraburgosur të dyshuarin. Prokurori ndërkombëtar parashtrroi ankesë kundër urdhërit për lirim dhe kolegji i gjykatësve e prishi vendimin e gjykatësit hetues dhe zgjati paraburgimin e të dyshuarit. Megjithatë, i dyshuari ishte liruar



në bazë të urdhërit të gjykatësi hetues, për shkak të dështimit të gjykatës që t'i komunikoj qendrës së paraburgimit vendimin e kolegjit.

Gjatë një hetimi në lidhje me veprën penale të trafikimit të kryer në Prizren, gjashtë meshkuj shqiptarë të Kosovës ishin arrestuar për shkak të, siç pohohet, për përfshirjen e tij në aktivitete kriminale, në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë. Tre prej të dyshuarve ishin arrestuar dhe, pas 24 orësh, hetuesit policor i dorëzuan lëndën Prokurorit Publik të Gjykatës së Qarkut për parashtrimin e rregullt të kërkesës për fillimin e hetimeve. Megjithate, pasi që lënda është dorëzuar të premtën pasdite, prokurori publik dështoi të parashtrij kërkesën gjykatësit hetues, duke pohuar se kjo nuk ishte e mundur për shkak se personeli i gjykatës tashmë kishte shkuar. Për të njëjtat arsye gjykatësi hetues nuk ka mundur të cakttoj e as të mbaj dëgjimin hetimor të shtunën apo të dielën. Si rrjedhojë e kësaj, me përfundimin e afatit kohor 72 orësh të paraparë për paraburgim, të tre të dyshuarit mëpastaj ishin liruar nga paraburgimi.

Në hetimet e kryera në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër një shqiptari të Kosovës, i dyshuar për vrasje, plaçkitje të armatosur dhe posedim të paligjshëm të armëve, urdhëri për paraburgim nuk ishte lëshuar fare nga gjykatësi hetues vendës për shkak se kërkesa për fillimin e hetimeve ishte parashtruar nga prokurori ndërkombëtar në gjuhën angleze dhe gjykata nuk kishte përkthyes në dispozicion për ta përkthyer kërkesën në fjalë. Si rezultat i dyshuari ishte liruar nga paraburgimi policor.

## **Menagjimi i fluksit të lëndëve**

Çështja se si secila gjykatë në përgjithësi, dhe si secili gjykatës apo trup gjykues në veçanti, organizojnë dhe caktojnë prioritetet në punën e tyre, prezenton një sfidë të vazhdueshme, jo vetëm për gjykatat në Kosovë por gjithashtu edhe për gjykatat në cilin do sistem tjetër gjyqësor. Megjithatë, ekzistojnë disa veçanti përkitazi me mënyrën e caktimit të gjykimeve dhe organizimit të procedurave gjyqësore në Kosovë, të cilat në veçanti, kërkojnë analizë më të thellë.

SMSL-ja ka dokumentuar një sërë rastesh ku vonesat e paarsyeshme në caktimin e gjykimeve, paraburgimet e paligjshme apo paraburgimet e zgjatura të paarsyetura janë shkaktuar nga mangësitë në sistemin e caktimit të prioritetëve në punën e gjykatave si nga gjykatësit ashtu edhe nga autoritetet që administrojnë me sistemin gjyqësor si të tillë.

Një aspekt tjetër sa i përket çështjes së menagjimit të fluksit të lëndëve është edhe caktimi i gjykimeve në atë mënyrë e cila shkon në të mirë jo vetëm të interesave të autoriteteve gjyqësore të cilat merren me rastin në fjalë mirëpo gjithashtu ato shkojnë në të mirë të të drejtave të palëve të përfshira në këtë proces me qëllim që ato të kenë qasje në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Vonesat e paarsyetuara përkitazi me caktimin e gjykimeve janë vërejtur nga SMSL-ja si në rastet e udhëhequra nga gjykatësit ndërkombëtar ashtu edhe nga ata vendas.

Një i pandehur shqiptar i Kosovës u detyrua që të pres deri në 13 muaj duke qëndruar në paraburgim derisa iu caktua gjykimi nga ana e Gjyqit të Qarkut në Mitrovicë. Pas

arrestimit më 17 maj 2000, i dyshuari e pranoi kallzimin penal për tentim vrasjen të ngritur kundër tij. Megjithatë përkundër faktit se aktakuza kundër tij është ngritur në gusht të vitit 2000, gjykata nuk arriti që të caktoj gjykimin deri më 19 qershor 2001,*d.m.th.*, nuk arriti që ta caktoj atë brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Vonesa të ngjashme janë dokumentuar nga SMSL-ja edhe në rastet të cilat kanë të bëjnë me të miturit. Ligji i aplikueshëm parasheh periudhën prej 8 ditësh që nga dorëzimi i aktakuzës brenda së cilës duhet të caktohet data e gjykimit për rastet të cilat kanë të bëjnë me të miturit.<sup>34</sup> Në një rast të plaçkitjes në Prizren, një i mitur i cili mbahej në paraburgim u detyrua që të pres më shumë se dy muaj derisa i është caktuar data e gjykimit. Zgjatje të ngjashme të procedurës ishin vërejtur edhe në gjykatat e tjera të qarkut.

Një shembull i rëndësishëm për tu ilustruar në këtë drejtim është Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në të cilën SMSL-ja gjer më tani ka arritur që të dokumentoj gjer në tetë raste për të cilat deri në dy vjet kanë kaluar prej momentit kur është ngritur aktakuza dhe 29 të tjera ku vonesat derisa është caktuar data e gjykimit ishin 1 vjet.

Sipas ligjit të aplikueshëm, kryetari i kolegjit të cilit i është ndarë rasti përkatës, është përgjegjës për caktimin e datës së gjykimit dhe atë jo më vonë se dy muaj prej momentit kur aktgjykimi është dorëzuar në gjyq. Kur ky afat kohor nuk përmbushet, kryetari i gjykatës në fjalë ka për detyrë të ndërmarrë hapa të nevojshëm për caktimin e gjykimit.<sup>35</sup> Rrjedhimisht, është përgjegjësi e gjykatësit dhe gjykatës për të ndërmarrë masa të nevojshme për caktimin e datës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Siç u përmend më lartë, edhe gjykatësit ndërkombëtarë janë përballur me probleme të ndryshme në fushën e menagjimit të fluksit të lëndëve. Kundër një të dyshuari serb nga Kosova i cili ishte arrestuar më 27 mars 2000 për vjedhje të rëndë u ngrit aktakuza, pasi që ai një muaj më vonë, më 28 prill 2000, pranoi plotësisht se e kishte kryer veprën penale në fjalë. Pasi që i bashkë-pandehuri kishte ikur nga paraburgimi pas arrestimit të tij, i pandehuri kundër të cilit është ngritur aktakuza u desh që të pres deri në një vjet derisa ishte caktuar data e gjykimit të tij. Përkundër dhënies së këtij rasti një gjykatësi ndërkombëtar në tetor të vitit 2000, gjykimi ishte caktuar për në prill të vitit 2001 dhe ishte kryer brenda një dite të vetme. Nuk u identifikuan ndonjë arsye objektive për vonesat gjatë caktimit të gjykimit për rastin në fjalë, siç ishte caktimi i gjykatësve përkatës që të merren me raste të tjera në rajonet tjera.

Një skenar i ngjashëm ishte vërejtur edhe në rastin e dy serbëve kundër të cilëve Gjykata e Qarkut në Mitrovicë kishte ngritur aktakuzën. Përpos që të akuzuarit u deshën që të qëndrojnë gati një vit në paraburgim para se kundër tyre ishte ngritur aktakuza, ata qëndruan edhe tetë muaj tjerë në paraburgim duke pritur që t'ju caktohet gjykimi. Së këndejmi, dy të pandehurit mëpastaj ishin liruar.

SMSL-ja konsideron se vonesat e tilla të pajustificueshme përkitazi me caktimin e datës së gjykimit pas ngritjes së aktakuzës dhe qëndrimi i të pandehurve në paraburgim gjatë fazës para mbajtjes së gjykimit paraqesin dështime administrative të gjykatës dhe zyrtarëve të saj që si pasojë kanë shkeljet serioze të të drejtës së të pandehurit për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor ose përndryshe duhet të lirohet. Interpretimi i

---

<sup>34</sup> Neni 484 LPP RFJ.

<sup>35</sup> Neni 279 LPP RFJ.

standarteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut na shpie deri te përfundimi se për individët të cilët akuzohen për kryerjen e një veprë të caktuar penale dhe si rezultat i kësaj mbahen në paraburgim gjatë fazës para gjykimit, organet shtetërore janë të obliguara që të shpejtojnë mbajtjen e gjykimit kundër tyre. Komisioni Europian mbështet faktin se edhe nëse periudha kohore e mbajtjes së një personi në paraburgim deri në mbajtjen e gjykimit kundër tij duket të jetë e arsyeshme na bazë të nenit 6(1) KNDNJ, mbajtja e një personi në paraburgim për atë periudhë të caktuar kohore mund të mos jetë e lejueshme në bazë të nenit 5 të Konventës Europiane “sepse qëllimi i gjithë kësaj është që të kufizohet kohëzgjatja e mbajtjes së një personi në paraburgim e jo të promovohet ideja për mbajtjen e gjykimeve të shpejta.”<sup>36</sup> Në fjalët e Gjykatës Europiane, personat e mbajtur në paraburgim gjatë fazës para mbajtjes së gjykimit kanë të drejtë në kujdes të veçantë e cila duhet t’ju kushtohet nga ana e autoriteteve gjatë zhvillimit të procedurës.<sup>37</sup>

### **Problemet tjera logjistike**

*Mungesa e interpretimit/përkthimit adekuat gjatë procedurave gjyqësore dhe shpërndarja jo e rregullt dhe përkthimet jo adekuate të Rregulloreve të UNMIK-ut.*

Sigurimi i interpretimit adekuat gjatë procedurave gjyqësore paraqet një shqetësim për SMSL-në, pasi që mungesa e tillë rezulton me një mospërputhje të procedurave gjyqësore me standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sidomos ato që kanë të bëjnë me të drejtën e personave që të gjykohen në gjuhën të cilën e kuptojnë. Përkundër seriozitetit të cilën e paraqet kjo çështje, ky raport nuk do të përqëndrohet aq shume në këtë çështje siç ishte rasti me dy raportet e kaluara të SMSL-së mbi sistemin e drejtësisë penale të cilat e shtjelluan këtë çështje më në thellësi.<sup>38</sup> SMSL-ja pranon faktin se janë arritur zhvillime pozitive në këtë drejtim sa i përket kësaj çështje. Për shembull, Departamenti i Drejtësisë ka ndërmarrë hapa konkret drejt punësimit të dhe emërimit të përkthyesve të kualifikuar që të ndihmojnë për sa i përket përkthimit/interpretimit në rastet e trafikimit, ku viktimat zakonisht vijnë nga vendet e Europës Lindore. Këto zhvillime vijnë si rezultat i rekomandimeve të bëra nga OSBE-ja.

SMSL-ja gjithashtu shpreh shqetësimin e saj përkitazi me mënyrën me të cilën rregulloret e UNMIK-ut janë përkthyer dhe shpërndarë gjyqëve dhe organeve tjera përkatëse si dhe në fund edhe publikut. Megjithatë, edhe pse kjo çështje paraqet një pjesë përbërëse të këtij raporti-administrimi i drejtësisë-ky aspekt nuk do të adresohet më tutje pasi që është adresuar në veçanti në dy raportet e kaluara të SMSL-së.<sup>39</sup>

*Mungesa e pajisjeve adekuate për përkthim*

Pas Rregullores së UNMIK-ut 2000/46 e cila e bën gjuhën Angleze si gjuhë të gjykatës në procedurat ku janë të kyqur gjykatësit apo prokurorët ndërkombëtarë, gjykimet shpesh herë mbahen në tri gjuhë – Shqip, Anglisht dhe Serbisht. Kjo kërkon mjete adekuate për përkthim simultan në mënyrë që të mos vështirësohet procedura me përkthim të njëpasnjëshëm në tri gjuhë. Pavarsisht nga fakti se gjykatësit dhe prokurorët e parë

<sup>36</sup> *Shih Haase kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, KNDNJ 12 Korrik 1977,

<sup>37</sup> *Shih Tomasi kundër Francës*, KNDNJ 27 Gusht 1992.

<sup>38</sup> *Shih para shenimin 1.*

<sup>39</sup> *Ibidem*

ndërkombëtarë u emëruan në Shkurt të vitit 2000, tani, dy vite më vonë, ende ekziston nevoja për mjete për përkthim simultan. I vetmi komplet i mjeteve për përkthim simultan – i cili megjithatë nuk funksionon – është i vendosur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

#### *Mungesa e Hapësirës*

Ekziston një mungesë e hapësirës si në zyret e gjykatave ashtu edhe nëpër gjykatore gjë që rezulton me zyre të stërmbushura me njerëz dhe me faktin se këta pastaj duhet të përdorin hapësirën e zyrës me rradhë dhe gjithashtu rezulton me vështirësi gjatë caktimit të datave të gjykimit.

Gjykata për Kundërvajtje në Gjiilan është e vendosur në ndërtesën e Gjykatës së Qarkut, me 6 gjykatës dhe 25 puntorë ndihmës të cilët janë të vendosur në 5 zyre. Gjykimet mbahen në mënyrën “me ndërrime” ashtu që një gjykatës mban gjykim në një zyre kurse të tjerët presin në korridor deri sa t’ju vij radha të tjerëve.

Po të kemi një numër më të madh të gjykatësve dhe prokurorëve atëherë ky problem do të bëhej edhe më i madh dhe do të duhej të zgjidhej sa më shpejt. Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë nuk ka mjaft hapësirë për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë dhe për momentin ata janë të vendosur në një ndërtesë tjetër e cila ndodhet në pjesën tjetër të qytetit. Kjo, së bashku me faktin se gjykatësit dhe prokurorët në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 janë duke i dëgjuar rastet e ndryshme nëpër tërë Kosovën, ka efektin e largimit të dy grupeve të gjykatësve dhe prokurorëve nga njëri tjetri gjë që zvogëlon funksionin e ndërtimit të kuadrove në kuadër të të dyja këtyre grupeve. Edhe pse një numër më i madh i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë është i dëshirueshëm me qëllim të shtimit të efikasitetit të punës së sistemit të drejtësisë, pa hapësirë të mjaftueshme nëpër gjykata vështirë se do të jemi në gjendje të zgjidhim problemin e vonësive të gjata përkitazi me caktimin e gjyqimeve dhe përfundimin me kohë të tyre.

#### *Mungesa e masave të sigurisë për anëtarët vendës të gjyqësisë*

SMSL-ja është e brengosur thellë përkitazi me trajtimin e pabarabartë të anëtarëve vendës të gjyqësisë në krahasim me ata ndërkombëtarë përse i përket sigurisë së tyre personale. Një numër mjaft i madh i gjyqtarëve dhe prokurorëve vendës janë ankuar mjaft gjatë këtyre dy viteve të fundit përse i përket presionit të vazhdueshëm që iu bëhet atyre nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe vëmendjen e vazhdueshme të cilën opinioni publik e përqëndron në ta, si dhe përkitazi me vëmendjen e pamjaftueshme të cilën ua kushton UNMIK-u përse i përket kërkesave të tyre në lidhje me sigurinë e tyre personale.

SMSL-ja konsideron se nëqoftëse presim që t’i plotësojmë standartet e paanshmërisë dhe pavarësisë atëherë anëtarët vendës të gjyqësisë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë sikurse edhe kolegët e tyre ndërkombëtarë sidomos kur kemi të bëjmë me sigurinë e tyre personale. Përderisa është i njohur fakti se gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë merren vetëm me raste të cilat janë tejet të ndjeshme, gjë që i mundëson atyre të kenë të drejtë për mbrojtje nga çfarëdo lloj revolte e drejtuar kundër tyre, SMSL-ja ka dokumentuar një sërë rastesh të cilat kishin rëndësi dhe ndjeshmëri të njëjtë sikurse edhe ato të cilat gjykoheshin nga apo ndjekeshin penalisht nga ana e profesionistëve gjyqësorë vendës. Duke u mohuar këtyre të fundit të drejtën për siguri personale ne vetëm se do të rrisim edhe mëtej hendekun ndërmjet të këtyre dy kategorive të profesionistëve gjyqësorë të cilët

edhe ashtu pritet të bashkëpunojnë ndërmjet veti. Pasi që nga ta kërkohet të kryejnë funksionet e tyre në një shoqëri e cila është duke u përballur me një krim të organizuar, mendoj se gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar nuk gëzojnë përkrahje të mjaftueshme me qëllim që të zhvillohen edhe mëtej në një trup të respektuar dhe të kualifikuar të profesionistëve gjyqësor. Nën rrethana të tilla, përpjekjet për ngritjen e kuadrove zvogëlohen në masë gjë që e bën edhe më të vështirë realizimin e qëllimeve të parashtruara mëparë përkitazi me ngritjen e kuadrove.

SMSL-ja konsideron se çështja e sigurisë së anëtarëve vendës të gjyqësisë duhet të adresohet për secilin rast dhe duhet të merret parasysh nga ana e UNMIK-ut po në të njëjtën mënyrë siç mirret kur kemi të bëjmë me gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar. Pa marrë parasysh se a mundet çështja e sigurisë personale të të gjykatësve dhe prokurorëve vendës të adresohet, si nga aspekti teknik ashtu edhe nga ai procedural, nga ana e Komitetit të UNMIK-ut për Vlerësimin e Shkallës së Kërcënimit, medoemos duhet të themelohet një organ i cili sipas nevojës do të ishte në gjendje të vlerësoj shkallën e pasigurisë dhe kërcënimeve të drejtuara kundër ndonjë gjyqtari apo prokurori të cilët janë të përfshirë në kryerjen e hetimeve apo gjykimet që kanë të bëjnë me raste të cilat janë tejet të ndjeshme.

## **Rekomandimet**

- SMSL-ja rekomandon se Rregullorja e UNMIK-ut 1999/26 duhet të abrogohet; periudha kohore për të mbajtur një person në paraburgim para ngritjes së aktakuzës duhet të kthehet në standartin origjinal 6 muaj, siç është e paraparë me Nenin 192 të LPP RFJ-së.
- Autoritetet administrative të gjyqësisë duhet të emërojnë më tepër pjesëtarë të minoriteteve (sidomos Serb) në kuadër të sistemit vendës të gjykatave.
- Njësia për Inspektim Gjyqësor (NjIGj) duhet të inicojë hetimet diciplinore në rastet kur gjykatësit janë përgjegjës për vonimet e paarsyeshme të dorëzimit të vendimeve me shkrim; gjatë së cilës një prioritet i veçantë duhet t'i jipet atyre rasteve kur vonesat përkatëse nuk u mundësojnë personave të paraburgosur që vendimi i tillë të shqyrtohet nga ana e gjykatës së instancës më të lartë.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK) duhet të organizoj trajnime për gjykatësit në fushën e menagjimit me fluksin e lëndëve. Praktikrat moderne të menagjimit duhet të promovohen dhe të implementohen, ashtu që gjykatësit të mësohen se si të përballen me stërngarkesat në normën e punës përderisa në të njëjtën kohë duhet t'i plotësojnë edhe konditat e ekspedivitetit.
- SMSL-ja rekomandon se edhe gjyqtarët porotë ashtu edhe ekspertët tjerë gjyqësor duhet të paguhën me kohë.
- Si mënyrë për të minimizuar vonimet gjatë mbajtjes së gjykimeve, duhet të instalohen mjetet e përkthimit simultan, si çështje urgjente, në secilën gjykatë ku gjykatësit apo prokurorët ndërkombëtarë kryejnë funksionet e tyre.
- Një strukturë e ngjajshme me atë të Komisionit Vlerësues të Kërcënimeve pranë UNMIK-ut duhet të themelohet përbrenda shtyllës së parë të UNMIK-ut për adresimin dhe vendosjen, për secilin rast, të arranzhimeve të sigurisë për gjykatësit dhe prokurorët vendës.

